



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr. Prot.
Dep. <u>2-D/DPK</u>	B: Prot. <u>01-2412/15</u>
Nr. i faq.	Prot. No.
Broj stranica	Data
Nr. pages <u>02</u>	Dat. <u>12-08.2015</u>
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit Nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores Nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 11.08.2015, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-02-859/15, për z. Mustaf Shala, Drejtor i Shkollës fillore 2 korriku në fshatin Loxhë të Komunës së Pejës, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për gjendje të konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik për zyrtarin publik, z. Mustafë Shala, Drejtor i Shkollës fillore 2 korriku në fshatin Loxhë të Komunës së Pejës, i cili është dyshuar se ka punësuar me konkurs djalin e tij z. Granit Shala në shkollën fillore 28 nëntori në fshatin Raushiq të Komunës së Pejës, në pozitën e punës mësimdhënës nga lënda edukatë muzikore dhe pastaj Drejtori i Arsimit i Komunës së Pejës z. Besim Avdimetaj me një rekomandim e ka transferuar z. Granit Shala në pozitën e punës mësimdhënës në lëndën kulturë muzikore në shkollën fillore 2 korriku të Loxhës, ku Drejtor i shkollës është babai i tij z. Mustafë Shala.

Drejtoria Komunale e Arsimit në Pejë në cilësinë e punëdhënësit ka hapë konkursë me datë 23.08.2014, për vende të lira të punës. Zyrtari publik z. Granit Shala, fillimisht është pranuar në punë në pozitën e punës mësimdhënës në lëndën kulturë muzikore në shkollën fillore 28 nëntori të fshatit Raushiq të Komunës së Pejës. Pas pranimi në mardhënie të punës nga Komisioni vlerësues Komunal, Drejtori Komunal i Arsimit në Pejë duke u bazuar në Ligjin për Arsimin Parauniversitar nr. 04/L-032, neni 35 (paragrafi 4), si dhe Udhëzimi Administrativ nr. 20/2013, ka rekomanduar që z. Granit Shala të sistemohet në shkollën fillore 2 korriku në fshatin Loxhë të Komunës së Pejës, për mësimdhënie në lëndën kulturë muzikore.

Pas analizimit të gjendjes dhe shqyrtimin të fakteve në dispozicion nuk kemi gjetë prova të mjaftueshme që vërtetetojnë gjendjen e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik. Zyrtari publik z. Mustafë Shala, gjatë ushtrimit të funksionit publik duhet të ketë parasysht deklarimin rast për rast të interesave lidhur me vendimmarrjen e caktuar.

Prokuroria Themelore në Pejë ka zhvilluar hetime penale për këtë rast dhe rasti është mbyllur nga Prokuroria Themelore në Pejë për arsye se nuk janë gjetë elemente të veprës penale për të cilën janë hetuar.

Inspektorati i Arsimit në MASHT së bashku me Inspeksionin e Arsimit në Pejë kanë inspektuar dosjen e Granit Shala dhe nuk ka gjetë ndonjë shkelje ligjore.

Spektori i inspeksionit të Arsimit në Pejë i ka rekomanduar Drejtorisë së Arsimit në Pejë që në të ardhmen kandidatët që i pranon në mardhënie pune, ti pranoi për vendet që konkurojnë sipas konkursit, mos të lëvizin nga një shkollë në tjetrin sepse në opinion po krijohet përshtypja e punësimeve pa konkurs.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit Nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

